



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE

Nr. 4420/1 prot.

Tiranë, më 27.6.2024

URDHËR

Nr. 486, datë 27.6.2024

PËR

NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR HARTIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT
PËR MINISTRINË E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL PËR PERIUdhËN
2024-2027

Mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 102, pika 4, e Ligjit Nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", Vendimit Nr. 516, datë 1.7.2020, të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 247, datë 20.3.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020" dhe miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2023 dhe Pasaportës së Indikatorëve", e Vendimit Nr. 608, datë 20.10.2021 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural",

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit të punës për hartimin e dokumentit, Plani i Integritetit për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, 2024-2027.
2. Grupi i Punës të kryesohet nga **znj. Elona Gjata**, Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike Administrative dhe ka në përbërje anëtar të Drejtorive në MBZHR.

Anëtarët e grupit të punës janë:

- a. **Z. Lavdrim Sahitaj**, Sekretar i Përgjithshëm
- b. **Z. Irfan Tarelli**, Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- c. **Z. Martin Mici**, Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit;
- d. **Z. Bledi Mile**, Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural;

- d. **Z. Altin Pasko**, Drejtor, Drejtoria e Auditimit;
- dh. **Znj. Eranda Selmanaj**, Drejtor, Drejtoria e Programimit dhe Monitorimit të IPARD;
- e. **Znj. Lindita Gjokazaj**, Përfaqësues i Njesisë së Sinjalizimit;
- ë. **Znj. Eneida Sokoli**, Sektori i Buxhetit (*edhe sekretariat*);
- f. **Znj. Elda Tahiraj**, Sektori i Përpunimit, Monitorimit të të Dhënave dhe Statistikave;
- g. **Znj. Elsa Vorfi**, Përfaqësues për Parandalimin e Konfliktit të Interesit;
- gj. **Znj. Arlinda Dedi**, Koordinator për të Drejtën e Informimit;
- h. **Znj. Kjara Vogli**, Koordinator për Konsultimin Publik.

3. Detyrat e grupit të punës janë:

Të hartojë planin e integritetit për vitin 2024-2027 edhe në zbatim të Strategjisë Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit, 2015-2023 dhe Planit të saj të Veprimit, 2020-2023 në përputhje me rekomandimin Nr. 2, të Raundit të V-të, të Vlerësimit "Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në qeverinë qendrore (funksionet e larta ekzekutive) dhe agjencitë e zbatimit të ligjit" të GRECO.

- 4. Në takimet e grupit të punës do të marrin pjesë edhe përfaqësues nga Kabineti i Ministrit të Bujqësisë për të lehtësuar vlerësimin e organizimit dhe funksionimit të stafit politik dhe identifikimin e masave për zbatimin e tij.
- 5. Drejtuesi i grupit të punës do të hartojë një kalendar pune për të gjitha fazat e hartimit të Planit të Integritetit, do të mbledhë grupin e punës, do të sigurojë konsultimin e draftit të planit të integritetit me konsultimin e Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator.
- 6. Të gjithë përfaqësuesit e Drejtorive të përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhëri, do të koordinojnë punën brenda drejtorive të tyre dhe do të garantojnë shqyrtimin e dokumenteve për vlerësimin e riskut të integritetit dhe hartimin e Planit të integritetit.
- 7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri anëtarët e grupit të punës.
- 8. Urdhëri i Ministrit Nr. 38, datë 24.1.2024 "Për ngritjen e grupit të punës për vazhdimin e monitorimit të planit të integritetit", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

